



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK  
KUÇOVË

Nr. Prot. 432 B

Kuçovë, më 31/12/2021

VENDIM

Nr. 81, Datë 23.12.2021

“PËR MIRATIMIN E VENDDEPOZITIMIT TË MBETJEVE BASHKIAKE “

Këshilli Bashkiak i mbledhur sot më datë \_\_\_\_\_.2021, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Transporteve, Shërbimeve Publike dhe e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit si dhe Drejtoria Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore si dhe në zbatim të ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, ligjit Nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, si dhe ligjit Nr. 10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”,

VENDOSI:

1. Të miratojë venddepozitimin e mbetjeve bashkiake për Bashkinë Kuçovë, me nr. Pasurie 733, me sipërfaqe totale 69173 m<sup>2</sup>, me zonë kadastrale 3227, në pronësi të Bashkisë Kuçovë, e cila ndodhet në fshatin Rreth Tapi, Njësia Administrative Perondi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Transporteve, Shërbimeve Publike dhe e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit si dhe Drejtoria Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore si dhe Inspektoriati i Policisë Bashkiak.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes .

Ky vendim u miratua me 18 vota Pro, — vota kundër dhe  
— vota abstenim.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK  
MIGENA BULLARI

